

Alois Niederstätter

Historia e Austrisë

Përktheu: Genc Lafa

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:
Alois Niederstätter
Geschichte Österreichs

Redaktoi: Jeta Hamzallari
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© Copyright 2007 W. Kohlhammer GmbH, Stuttgart

© Copyright of the translation:

S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

© Copyright për botimin shqip, DITURIA, 2015



Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Europë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës së Gjermanisë, Fondacioni Kulturor i Zvicrës "Pro Helvetia", Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë, "KulturKontakt Austria", Instituti "Goethe", Agjencia Sllovene e Librit "JAK", Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë dhe fondacioni "S. Fischer".

Botuesi falënderon Ambasadën e Austrisë në Tiranë
dhe Bankën Raiffeisen për mbështetjen.



Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503
E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al

Shtëpia Botuese DITURIA

Përmbajtja

Parathënie	5
Në periferi të Perandorisë Romake (Nga shekulli i 1 p.e.s. deri në shekullin e 5 e.r.)	11
Shpërbërje dhe integrim: Formimi i trevave në Alpet Lindore dhe në Danub (shekujt 5-10)	19
Ostarrichi: Nga marka babenberge te dukata (shekulli i 10 deri më 1246)	30
Dukata, marka dhe konte (shekujt 10-12)	40
“Ndërbretërimi austriak”: Fati dhe fundi i mbretit Otakar (1246-1278)	46
Konsolidimi dhe zgjerimi i pushtetit të Habsburgëve	50
Mbreti Rudolfi I, bijtë dhe nipat e tij (1278-1358)	50
Duka Rudolfi IV	61
Grindjet familjare dhe ndarja e tokave (1365-1493)	68
Principata kryeipeshkvnore e Salzburgut në Mesjetën e vonë	82
Princi dhe vendi: Lindja e qyteteve	86
Shoqëria mesjetare	91
Kultura në Mesjetë	110
Veprimtaria shkrimore dhe historiografia	110
Arsimi	111
Poezia	113
Arkitektura dhe arti figurativ	115
Nga Mesjeta në Kohën e Re: Sundimi i Maximilianit I (1493-1519)	120

Austria nën Ferdinandin I dhe bijtë e tij: Reformacioni, luftërat fshatare dhe rreziku turk (1519-1576)	127
Epoka e Kundërreformacionit	137
“Lufta e gjatë me turqit” dhe “grindja e vëllezërve në familjen Habsburg”	137
Lufta Tridhjetëvjeçare (1618-1648)	142
Rifillimi i luftërave me turqit, rrethimi i dytë i Vjenës (1683) dhe Lufta e Pasardhjes Trashëgimore Spanjolle (1701-1714)	149
Principata kryeipeshkvnore e Salzburgut	157
Në rrugën drejt shtetit “modern”:	
Monarkia habsburge në shekullin e 18	161
Sanksioni pragmatik (1713), aleanca të ndërrueshme dhe vijimi i luftërave me turqit	161
“Perandoresha” Maria Theresia: Luftërat për pasardhjen trashëgimore austriake dhe për Silezinë, si dhe fillimi i reformave të mëdha	165
Josephi II dhe vepra e tij reformatore	174
Shndërrimi social dhe kulturor në fillim të Kohës së Re	180
Luftërat e Koalicionit, Perandoria e Austrisë dhe riorganizimi i Europës në Kongresin e Vjenës	203
“Paramarsi” dhe Revolucioni (1814-1849)	215
“Sistemi Metternich”	215
Biedermeier: Shoqëria dhe kultura në gjysmën e parë të shekullit të 19	219
Revolucioni i vitit 1848	224
Epoka e perandorit Franz Joseph I (1848-1916)	229
Neoabsolutizmi (1814-1859)	230
Riorganizimi shtetëror dhe zgjidhja e çështjes gjermane “Kompensimi” (<i>Ausgleich</i>) me Hungarinë i vitit 1867	231
dhe era liberale (deri më 1879)	235
Qeveria konservatore Taaffe (1879-1893)	242
Në rrugën drejt katastrofës	245
Shndërrimi social	253
Arsimi dhe shkenca	258
Historizëm dhe modernitet - krijimtaria artistike	261

<i>Përmbajtja</i>	7
Lufta e Parë Botërore dhe rrënimi i monarkisë danubiane	266
Republika e Parë (1918-1938)	273
<i>Et ce qui reste, c'est l'Autriche</i> - Themelimi i Republikës së Austrisë dhe zhvillimi i saj deri më 1933	273
“Shteti i shtresave” (1934-1938)	283
Arti dhe shkenca ndërmjet luftërave botërore	287
“Bashkimi” me Gjermaninë e Hitlerit, sundimi nacionalsocialist dhe Lufta e Dytë Botërore (1938-1945)	291
Republika e Dytë (që nga viti 1945)	298
Austria nën pushtimin aleat	298
Traktati shtetëror dhe kombi austriak	308
Nga Koalicioni i Madh të qeverisja e vetme e ÖVP-së	310
Era Kreisky (1970-1983)	313
Stanjacion dhe ndryshim rrënjësor: Austria në fillim të shekullit të 21	317
Bibliografi e përzgjedhur	329
Tabelë kronologjike	349
Hartat	
Harta 1 Provincat romake në trevën e Alpeve Lindore dhe të Danubit	13
Harta 2 Zona e pushtetit të Babenbergëve	31
Harta 3 Sfera e pushtetit të Habsburgëve në fund të shekullit të 14	69
Harta 4 “Kompromisi” (Ausgleich) austro-hungarez 1867	236
Harta 5 Shtetet pasuese të Monarkisë së Danubit	275
Harta 6 Zonat e pushtimit 1945-1955	299
Tabelat gjenealogjike	
Tabela gjenealogjike 1 Babenbergët	360
Tabela gjenealogjike 2 Nga Rudolfi I të Maximiliani I	361
Tabela gjenealogjike 3 Linja austriake e Habsburgëve (Shek. 16-18)	362

Tabela gjenealogjike 4	Shtëpia Habsburg-Lorena	363
Tabela gjenealogjike 5	Dega perandorake e Shtëpisë Habsburg-Lorena	364
Hartat dhe tabelat gjenealogjike nga Peter Palm, Berlin		
Tregues i emrave		365

Parathënie

Shtetet e sotme dhe kufijtë e tyre rrallë përputhen me territoret historike ose trevat që lidhen me to. Para një problemi të tillë gjendet edhe ai që dëshiron të shkruajë një histori të Austrisë. Nëse republika e sotme përbën kuadrin e saj, ai vërtet përmban *Ostarrichin* babengerg si bërthamë historike, në përgjithësi dukatat e Austrisë, Steierit dhe Karintisë (Kärnten), siç i futën në zotërimin e tyre Habsburgët në Mesjetën e vonë, por jo pronat e tyre familjare në perëndimin aleman, në Adriatik dhe vetëm një pjesë të kontesë së Tirolit. Përkundrazi, territori i kryeipeshkëve të Salzburgut deri në fillim të shekullit të 19 ishte jashtë Austrisë. Së fundi, me marrjen e kurorës së Wenzelit* dhe të Stefanit**, historia çeke dhe ajo hungareze u ndërthurën në mënyrë të pazgjidhshme për shekuj me radhë me atë austriake. Në kontekstin europian një rol të rëndësishëm ka luajtur jo vetëm shteti perandorak dhe Monarkia e dyfishtë Austro-Hungareze, duke qenë se Habsburgët që nga mesi i shekullit të 15 e thuan vazhdimisht vendosnin edhe perandorin e Perandorisë së Shenjtë Romake. Për të dhënë një prerje historike gjatësore, e cila të shtrihet që nga përfshirja në Perandorinë Romake e trevës së Alpeve Lindore e deri në ditët e sotme, mbetet vetëm kompromisi që fokusi i saj të vendoset në trevën e shtetit të sotëm, por vështrimi të zgjerohet edhe më tej, kur një gjë e tillë të shihet e nevojshme. Për ta shpjeguar në njëfarë mase kënaqshëm konceptin shumëstresor “Austri” (*Österreich*) përtej aspekteve dinastike-territoriale, duhen shqyrtuar tema qendrore të historisë sociale, ekonomike dhe kulturore, të paktën në fillesat e tyre.

* Kurora e mbretërisë së Bohemisë (të gjitha shënimet janë të përkthyesit).

** Kurora e mbretërisë së Hungarisë.

Për shkak të kufizimit të diktuar nga parametri vëllimor, këtu, sidoqoftë, ishte e mundur të realizohej vetëm një paraqitje shumë e thukët, një ndihmë për t'u orientuar përmes dy mijëvjeçarëve të historisë së trevës alpine dhe danubiane "austriake". U desh të hiqet dorë tërësisht nga një mori ngjarjesh, të dhënash, faktesh dhe strukturash, të tjera u desh të mbeten të pashtjelluara më tej. Si rrjedhim, një rëndësi të veçantë ka referimi ndaj bibliografisë së përzgjedhur të dhënë në shtojcë. Ky bëhet edhe më i lehtë, duke qenë se së fundi ka dalë nga shtypi vëllimi i 14 dhe i fundit i "Österreichische Geschichte" (*Historia e Austrisë*) që botohet prej vitit 1994 nga Herwig Wolfram, e cila përfaqëson gjendjen kërkimore-studimore në bazë më të gjerë.

Zonjën Monica Wejwar dhe shtëpinë botuese Kohlhammer i falënderoj për zemërsisht për përkujdesjen dhe lektorimin e përkushtuar, familjes sime - si shpeshherë tashmë - i jam shumë mirënjohës për mirëkuptimin që ka treguar.

Dornbirn, janar 2007

Alois Niederstätter

Në periferi të Perandorisë Romake (Nga shekulli i 1 p.e.s. deri në shekullin e 5 e.r.)

Struktura politike më e rëndësishme para pushtimit romak në trevën e Alpeve Lindore ishte Mbretëria e Norikumit (*Regnum Noricum*). Në të bënin pjesë populli i norikëve, si dhe fise të tjera kelte, të cilat i nënshtroheshin hegjemonisë së mbretit norik. Bërthama territoriale e pushtetit të tij ndodhej në Karinti, në ngulimin e Magdalensbergut (në kohën e romakëve *Virunum*). Nga perëndimi Norikumi shtrihej deri në krahinën e Salzburgut si dhe përmes Tirolit Lindor deri në luginën e Pusterit (*Pustertal*), nga veriu dhe lindja përmes trevës danubiane deri në skajin perëndimor të ultësirës hungareze. Mbretërit norikë ishin aleatë të Romës; treva e sundimit të tyre u shërbente romakëve si zonë e ndërmjetme sigurie dhe si zonë ekonomike furnizimi, e cila mbështetej në prodhimin e hekurit të cilësisë së lartë, i orientuar drejt eksportit, si dhe në vendburimet e arit. Austria Verilindore me pellgun e Vjenës përfshinte trevën e banimit të boiëve*. Në trevën e Tirolit dhe në luginën e Rinit alpin jetonin lidhje fisnore më të vogla, të cilat ndoshta i përkisnin popullit alpin jugor të retëve, por të paktën në dhjetëvjeçarët para fillimit të Erës së Re gjendeshin nën ndikimin e fortë kelt.


Kontaktet në rritje me jugun gjatë shekullit të 1 e.r. i ndryshuan në mënyrë të përhershme mënyrat dhe kontekstet e jetesës në Alpet Lindore, veçanërisht që kur Jul Cezari përparoi me këmbëngulje, duke hapur rrugën drejt skajit juglindor të Alpeve. Për shkak të luftërave me galët, u rrit

* Fis kelt (lat. *Boii*) që jetonte në trevën e Austrisë Verilindore, të Bohemisë dhe Bavarisë Lindore. Emri i tyre gjendet edhe në rrënjën e etnonimit *Bajuwaren* (nga gjerm. e vj. *baio-warioz*) dhe të emërvendit *Bohemia* (nga gjerm. e vj. *boio-hemum* "vendi i bojerëve").

interesi i romakëve për hekurin norik, ndërsa keltët e Alpeve përfituan nga përparësia teknologjike e trevës mesdhetare. Përfshirja e drejtpërdrejtë e trevës alpine në Perandorinë Romake u kthye në qëllim politik dhe ushtarak vetëm me fillimin e epokës perandorake. Veprime më të vogla ushtarake i shërbyen përgatitjes së fushatës, të caktuar në verën e vitit 15 e.r., nën komandën e Drusit dhe Tiberit, thjeshtave të perandorit August. Drusi përparoi, siç hamendësohet, nga Italia e Veriut, përmes krahinës së Adiges/Etsch, Vinschgaut dhe qafës Reschen (*Reschenpass*) në luginën e Innit, për të arritur më pas, përmes qafës Fern (*Fernpass*)* dhe qafës malore të Seefeldit (*Seefelder Sattel*), në paratokën alpine. Ndërsa Tiberi erdhi nga Galia, u priu njërive të tij përgjatë Rinit të Sipërm drejt Liqenit të Konstancës (*Bodensee*) dhe, së fundi, më tej, drejt burimeve të Danubit. Për shkallën e vërtetë të veprimeve luftarake dimë pak. Në *Tropaeum Alpinum*, e ngritur si përmendore fitoreje për Augustin në La Turbie (Monako), përmendeshin gati 50, fise të cilat ishin mundur atëherë. Jo pak syresh, përballë epërsisë së kundërshtarit, iu nënshtruan pa luftë pushtetit romak. Kështu duhet të ketë ndodhur edhe me Mbretërinë Norike, e cila si shpërblim ruajti një lloj autonomie të brendshme. Fiset gjermane të markomanëve dhe kuadëve (*Quadi*) që banonin në veri të Danubit u lidhën me Romën përmes traktatësh.

Në dhjetëvjeçarët e parë pas pushtimit të trevës së Alpeve Lindore, ushtria mbajti peshën kryesore të përfshirjes së saj në Perandori. Por keltët e mbetur në trevën alpine ose paraalpine vijuan të përbënin bërthamën e popullsisë së provincës dhe e ruajtën identitetin e tyre kulturor edhe nën sundimin romak. Veçanërisht përfytyrimet fetare u treguan jetëgjata. Në përgjithësi romanizimi në jug të Alpeve përparoi më vullshëm se në trevën veriore paraalpine, ku në fund të shekullit të 2 e.r. përgjithësisht ishte përmbyllur. Parakusht për këtë ishte krijimi ose zgjerimi i një rrjeti rrugësh, kryesisht rrugë lidhëse veri-jug përmes kreshtës kryesore alpine: skajin më perëndimor të Austrisë së sotme e prekte rruga që vinte nga Milanoja dhe, përgjatë liqenit të Comos, Splügenit,

* Në Alpet e Tirolit.



Harta 1: Provincat romake në trevën e Alpeve Lindore dhe të Danubit.

luginës së Rinit alpin (Rinit të Sipërm), arrinte në Liqenin e Konstancës e më pas, përmes Kemptenit, në Augsburg. Më tej në lindje Via Claudia Augusta, përmes luginës së Adiges dhe qafës Reschen shpinte në luginën e Innit dhe që atje, përmes qafës së Fernit, në trevën paraalpine të Bavarisë. Nga Friuli, përmes qafës së Plöckenit (*Plöckenpass*) apo Tarvisios arrihej në Karinti e më tej në luginën e Salzacht (Salzachtal) ose “në rrugën kryesore norike” dhe, përmes qafës së Neumarktit (*Neumarkter Sattel*), qafës Tiebener Tauern dhe qafës së Phyrnit (*Phyrnpass*), në Danub.

Nën sundimin e perandorëve Tiber dhe Kaligula strukturat e administratës civile u përforcuan duke mundësuar së fundi, nën Klaudin (41-54 e.r.), krijimin e provincave. Nga Austria e sotme, Vorarlbergu dhe pjesa më e madhe e Tirolit i takonin Retisë; përveç tyre, kësaj i takonin edhe treva paraalpine deri në Danub dhe zona të Zvicrës Lindore. Retisë në lindje iu bashkua provinca e Norikimit. Kufirin e saj verior e formonte Danubi, në jug ajo shtrihej deri në kreshtat e Alpeve karnike (*Karnische Alpen*) dhe në malet Karavanke (*Karawanken*), më tej në lindje deri në Savë. Zona “austriake” e provincës së Panonisë, e cila u krijua përmes ndarjes së provincës së Ilirikimit, ishin Burgenlandi dhe pellgu i Vjenës. Qendra norike *Virunum* u zhvendos, gjatë krijimit të provincës, nga Magdalensbergu në Zollfeld, në lindje të Glanit (ndërmjet Klagenfurtit dhe St. Veitit, Karinti). Përveç “kryeqytetit të provincës” lindën, që në kohën e Klaudit, *Teurnia* (në perëndim të Spittalit në Dravë, Karinti), *Auguntumi* (në luginën e sipërme të Dravës, Tirol Lindor), si dhe *Iuvoavum* në veri të Alpeve (Salzburg). Në kohën e Flavit, këtyre iu shtua edhe *Flavia Solva* (Leibnitz, Steiermark). Në Panoni, vëndfushimi i legjioneve *Carnuntum* (në zonën e komunave Petronell-Carnuntum dhe Bad Deutsch-Altenburg, Austri e Poshtme), ku Rruga e Qelibarit* kapërcente Danubin, fitoi rëndësi të veçantë. Në Reti, në bregun lindor të Liqenit të Konstancës, nga një vëndfushim ushtarak *Brigantium*

* Me këtë emër përkufizohen rrugë të ndryshme tregtare, përmes të cilave kryhej “ndër të tjera” transporti i qelibarit nga brigjet e Baltikut dhe Detit të Veriut drejt trevës mesdhetare.

(Bregenz) u zhvillua një ngulim i ngjashëm me një qytet.

Për sigurimin e kufirit verior fillimisht të hapur përgjatë Danubit u ngritën fushime ushtarake të fortifikuara (*kastele*, lat. *castellum*). Ndërtime të tilla dëshmojnë në Norikum ndër të tjera edhe në vende si Linz, Traismaur, Mautern, Tulln dhe Zwetendorf. Një varg vendfushimesh dhe kullash vrojtimi formonin *Limesin* e Danubit; rruga e *Limesit* lidhte pikëmbështetjet ndërmjet tyre. Për furnizimin e vendfushimeve ushtarake u ngritën fshatra (*vici*), ndonjëherë me përmasa të konsiderueshme. Gjatë shekullit të 1, struktura e vendbanimeve u dendësua edhe në brendësi të provincave; në vendet e përshtatshme për komunikacion lindën *vici*, të cilët shërbenin si pikëmbështetje për tregtinë e zejet dhe zhvilluan pjesërisht standarde kryeqendre. Jashtë fshatrave mbizotëronte *villa rustica* si formë vendbanimi, toka-pronë (*Gutshof*) me ndërtesa pjesërisht luksoze.

Luftërat kundër markomanëve, kuadëve dhe veçanërisht kundër dakëve e ndryshuan gjendjen në Panoni. Rreth vitit 106 provinca u nda; në Panoninë e Sipërme kryeqendër u bë *Carnuntumi*, një tjetër fushim legjionesh u krijua në *Vindobona* (Vjenë). Këtyre në Norikum iu shtuan gjithashtu, në gjysmën e parë të shekullit të 2, *Ovilava* (Wels) dhe *Aelium Cetium* (St. Pölten). Vendbanimet qytetare kishin një standard të lartë civilizimi. Furnizimi me ujë dhe sistemet e kullimit të ujërave të zeza, ngrohja, ndërtesat publike dhe private me shumë zbulime, tempujt, por edhe ndërtimet fortifikuese të kushtueshme ishin të vetëkuptueshme. Amfiteatri i qytetit civil *Carnuntum* ofronte vende për 13 000 shikues.

Pas 150 vjetësh të kaluar përgjithësisht në paqe, në veri të Danubit lindi një vatër trazirash, kur fise germanike lindore u shtynë drejt jugut dhe si rrjedhim, markomanët dhe kuadët që jetonin në Bohemi, Moravi dhe në Hungarinë Veriore u vunë në lëvizje. Më 169, ata përparuan deri në Italinë e Veriut, grupe më të vogla ranë në Norikum e Panoni, dhe në përmasa më të vogla edhe në Reti. Për të rivendosur gjendjen e mëparshme Romakët bënë dy luftëra me markomanët në vitet 60 dhe 70 dhe e përforcuan praninë luftarake në Reti dhe Norikum; u krijuan vendfushime të reja legjionarësh, si ai në